



12

KONTRATË PENGU MBI KUOTAT

Ne Tirane, sot me 14.05 2019 (dy mije e nentembdhjete), ne Zyren e Noterise Tirane para meje Noteres Eriketa Kokoli, me seli ne Rruga "Sami Frasheri", Pallati i ri prane Drejtorise se Policise, kati IV, u paraqiten palet qe kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate si me poshte:

- a) **Shoqëria Bankare "BANKA e TIRANËS" SH.A**, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vepron si BANKË me Licensën Nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, NIPT J61924008V, me seli në adresen Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtores e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti**, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kongresi i Manastirit", Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaporte Nr. H85306150N dhe **Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida CENGU**, e bija e Azemit, lindur me 16.02.1970 ne Kukës dhe banuese ne Tirane, me leternjoftim Nr.025225466, te dy madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe në vazhdim do të quhet "Banka"); dhe
- b) **Shoqeria Tregtare "ANAMARK" SH.P.K.**, me adrese: Kashar, Ish Ndermarrja e Karburanteve, Km.1 i Autostrades Tirane-Durres, Zona Kadastrale 2679, Passuria Nr.52/7, Tirane, Shqiperi, e krijuar dhe vepron ne baze te ligjeve shqiptare, regjistruar ne Organet Tatimore, me numer NUIS Nr.L52418031N, perfaqesuar ketu ne baze te vendimit te **Ortakut te Vetem të dates 10.05.2019** (me Nr.2312Rep/Nr.1028Kol të noteres Edlira Malaj) nga **Z.Klodian Allajbeu**, i biri i Fadilit, lindur në Berat më 21.04.1978 dhe banues në Tirane, ne adresen Njesia Bashkiake Nr.5, Deshmoret e 4 Shkurtit, Nderresa Nr.58, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes Nr.BR2143219, me numër personal Nr.H80421164I (në vijim i quajtur "Penglënësi").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. Banka me **Kontratë Kredie Bankare për Pasuri të Paluajtshme Nr.CO.896/10.05.2019** i ka akorduar Kredimarrësit, z. Klodian Allajbeu dhe znj. Iris Allajbeu, nje kredi ne shumen **Euro 2,450,000 (dy milion e katerqind e pesedhjete mije Euro)** (në vijim i quajtur "Borxhi").
2. Penglënësi është zotërues i 1 (një) kuote (pjesë e kapitalit) në kapitalin e shoqërisë "EKMA ALBANIA" Sh.p.k. Kjo Kuotë me vlerë 33,360 LEKË (tridhjetë e tre mijë e treqind e

A

gjashtëdhjetë lekë), që është paguar plotësisht dhe i korrespondon pjesëmarrjes në total të Penglënësit në kapitalin e kësaj shoqërie, përfaqëson 33.36% të kapitalit të paguar të shoqërisë "EKMA ALBANIA" Sh.p.k. Penglënësi deklaron se janë kryer të gjitha regjistrimet përkatëse lidhur me zotërimin e kësaj kuote si në Regjistrin e Ortakëve nëse shoqëria mban një të tillë, ashtu edhe në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kështu, për të siguruar pagimin në kohë dhe të rregullt të Borxhit, Penglënësi lë peng në favor të "BANKA e TIRANËS" SH.A, kuotën e sipër përmendur të zotëruar prej tij aktualisht në kapitalin e shoqërisë "EKMA ALBANIA" Sh.p.k , çdo kuotë të re që do të zotërojë në të ardhmen në këtë shoqëri si dhe të drejtat e lidhura me kuotat siç parashikuar në klauzolat 5 - 7 mëposhtë të kësaj Kontrate (në vijim e quajtur "Kuota").

3. Penglënësi deklaron këtu se ai ka pronësinë e plotë mbi Kuotën e sipër përmendur, e cila është e lirë nga çdo barrë, e drejtë e të tretëve ose pengesë tjetër ligjore. Gjithashtu, Penglënësi deklaron këtu se ka të drejtë ta përdorë Kuotën si garanci duke e lënë peng.
4. Penglënësi angazhohet dhe merr përsipër që:
 - (a) të mos tjetërsojë Kuotën ose çdo interes të lidhur me të (përfshirë këtu asetet dhe/ ose aktivitetin e shoqërisë dhe/ose zmadhimin e kapitalit që mund të ndikojë në zvogëlimin e pjesëmarrjes së Penglënësit në kapital) pa miratim të mëparshëm me shkrim të Bankës;
 - (b) të mos vendosë detyrime të tjera apo t'u japë të drejta reale të tretëve mbi Kuotën pa miratim të mëparshëm me shkrim të Bankës;
 - (c) të nënshkruajë dhe dërgojë menjëherë të gjitha dokumentat si dhe të marrë gjithë veprimet e nevojshme apo të këshillueshme në mënyrë që:
 - (i) të kompletojë dhe të mbajë në fuqi të plotë pengun sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate;
 - (ii) të sigurojë që mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe të drejtat e ortakut të lidhura me to të nënshkruara nga Penglënësi, të jetë regjistruar pengun në favor të Bankës në përputhje me sa përcaktuar në klauzolën 2 mësipër; dhe
 - (iii) t'i mundësojë Bankës të ushtrojë të drejtat dhe mjetet juridike që ajo ka të drejtë në përputhje me këtë Kontratë, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha të drejtat dhe mjetet juridike të ushtrueshme pas ndodhjes së një Rasti Mospërbushjeje sipas dispozitave të Kontratës së Kredisë.
5. Pengu shtrihet ipso jure mbi të gjitha të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga Kuota e lënë peng. Si rrjedhim, Banka në përputhje me parashikimet e Nenit 550 të Kodit Civil, në rast mospërbushjeje ka të drejtë të marrë, pa asnjë urdhër ose veprim tjetër nga Penglënësi, çdo dividend, interes ose përfitim tjetër lidhur me Kuotën dhe, në vijim, të kreditojë të ardhurat neto kundrejt Borxhit.
6. Pengu shtrihet mbi të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kuotës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit lidhur me Kuotën. Rrjedhimisht, gjatë kësaj kontrate dhe derisa nuk është vërtetuar ndonjë Rast Mospërbushjeje në përputhje me parashikimet e Kontratës së Kredisë, të drejtat e votës të lidhura me Kuotën, në asamblenë e ortakëve të shoqërisë, do të ushtrohen nga Penglënësi, me kusht që këto të drejta të mos ushtrohen në

IPERISE
OKULLI

asnjë rast nga Pengdhënesi në një mënyrë të tillë që do të mund të cënonte vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Kontrate dhe/ose e cila nuk është në përputhje me dispozitat e Kontratës të Kredisë apo çdo kontrate tjetër të lidhur me të.

7. Bazuar në krijimin e pengut, Penglënësi i kalon Bankës çdo dhe gjithë të drejtat që ka në bazë të ligjit dhe të statutit si ortak në shoqërinë, kuotat e së cilës vendosen peng, si dhe të drejtën të marrë çdo kuotë të re, letër me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (qoftë me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimin, këmbimin ose ndryshe) në lidhje me ose mbi cilëndo kuotë etj., pa qenë e nevojshme ndonjë urdhër ose veprim i mëtejshëm i Penglënësit. Penglënësi i kalon Bankës të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka ndaj shoqërisë në cilësinë e ortakut.
8. Në vështirim të çdo dhe të të gjitha të drejtave dhënë Bankës në bazë të kësaj Kontrate, Banka me vërtetimin e një Rasti Mospërmbushje në përputhje me dispozitat e Kontratës së Kredisë, do t'i dërgojë një njoftim Barrëdhënësit dhe Shoqërisë duke informuar se është vërtetuar një rast mospërmbushje dhe Banka ka të drejtë por nuk është e detyruar që:
 - (i) të ushtrojë të drejtat e votës që lidhen me kuotat, në asamblenë e zakonshme dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të ortakëve të Shoqërisë; dhe
 - (ii) të përftojë të gjithë dividendët, interesat që lidhen me kuotat
9. Çdo dhe të gjitha shpenzimet gjyqësore ose jashtë gjyqësore të bëra nga Banka për të siguruar ose ruajtur të drejtat e saj që rrjedhin nga ose lidhur me këtë Kontratë, do të përballohen nga Penglënësi dhe do të debitohen në llogarinë e tij.
10. Kjo Kontratë do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin, ekzekutimin ose zbatimin e saj, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente e Tiranës.
11. Banka ka të drejtë të likuideojë Kuotat e lëna peng kur Borxhi është bërë i detyrueshëm dhe i pagueshëm dhe pas zbritjeve të taksave, shpenzimeve dhe ngarkimeve përkatëse, të ndjekë procedurat e shitjes kundrejt Borxhit.
12. Palët kontraktuese pranojnë se Penglënësi do të proçedojë me njoftimin me postë të regjistruar të kësaj kontrate të shoqërisë "EKMA ALBANIA" Sh.p.k, në mënyrë që kjo e fundit të informohet rregullisht për kontekstin sa më sipër si dhe të bëjë regjistrimin e pengut mbi Kuotat në Regjistrin e Ortakëve nëse shoqëria mban një të tillë si dhe në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
13. Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë nënshkruhet në pesë origjinale, nga një për palët kontraktuese, një për shoqërinë "EKMA ALBANIA" Sh.p.k, një për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe e pesta të mbahet nga Noteri Publik.

Kjo Kontratë Pengu hartohet në bazë të Neneve 546, 547 e në vazhdim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan me zë

të lartë dhe e kuptuan, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan rregullisht dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjës.



PALËT KONTRAKTUESE

PENGLËNËS

Shoqeria ANAMARK sh.p.k
perfaqesuar nga:

1. Klodian Alaj

[Signature]

PENGMARRËS

“BANKA e TIRANËS” SH.A.
përfaqësuar nga:

[Signature]
Drejtoresh e Divizionit të Korporatave

[Signature]
Drejtoresh e Departamentit të Administrimit të Kredive

NOTE RE
ERIKETA KOKOLI

[Signature]
[Signature]





VENDIM

I

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TË SHOQËRISË "ANAMARK" shpk

Sot ne daten 10 /05/2019 , ne pranine time , notere Edlira Malaj(Galanxhi), anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli ne Rr. "Sami Frasheri" Tirane,u zhvillua mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Anamark" shpk ,e regjistruar ne QKB me NUIS L52418031N, me seli ne Kashar, Tirane ,me pjesemarrjen e ortakut te vetem te shoqerise z.Klodian Allajbeu, Ortak zotërues i 100 % (njëqind për qind) të pjesëve të kapitalit te shoqërisë "Anamark" Sh.p.k, bazuar në rendin e ditës si vijon:

RENDI I DITES

1. Të miratojë vendosjen e pengut mbi kuotat e shoqerise "Anamark" shpk, ne cilesine e ortakut te shoqerise "Ekma Albania" shpk,zoteruese e nje kuote qe perfaqeson 33,36 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise "Ekma Albania", si garanci për shlyerjen e detyrimeve të rrjedhura nga Kontrata e Kredisë per kredine bankare ne vleren 2 450 000 (dy milion e katerqind e pesedhete mije euro) që do t'i akordohet z. Klodian Allajbeu prane Tirana Bank sha.
2. Të miratojë dhënien e tagrave të përfaqesimit të shoqërisë z. Klodian Allajbeu, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes Siguruese si dhe të çdo lloj akti tjetër ligjor dhe pse të papërmendur shprehimisht në këtë Vendim me qëllim që të realizohet gjithcka sa përshkruar me lart.
3. Të regjistrojë Vendimin e mësipërm në Regjistrin e Vendimeve të shoqërisë

Ne perfundim, pas shqyrtimit te rendit te dites, mbeshetur ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ortakut i vetem i shoqerise "ANAMARK" shpk

VENDOSI

1. Të miratojë vendosjen e pengut mbi kuotat e shoqerise "Anamark" shpk, ne cilesine e ortakut te shoqerise "Ekma Albania" shpk,zoteruese e nje kuote qe perfaqeson 33,36 % te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise "Ekma Albania", si garanci për shlyerjen e detyrimeve të rrjedhura nga Kontrata e Kredisë per kredine bankare ne vleren 2 450 000 (dy milion e katerqind e pesedhete mije euro) që do t'i akordohet z. Klodian Allajbeu prane Tirana Bank sha.
2. Të miratojë dhënien e tagrave të përfaqesimit të shoqërisë z. Klodian Allajbeu, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes Siguruese si dhe të çdo lloj akti tjetër ligjor dhe pse të papërmendur shprehimisht në këtë Vendim me qëllim që të realizohet gjithcka sa përshkruar me lart.
3. Të regjistrojë Vendimin e mësipërm në Regjistrin e Vendimeve të shoqërisë

Ortakut i vetëm është në dijeni të efekteve juridike që këto veprime juridike prodhojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe pasi i deklaron të drejta dhe të ligjshme të lidhura në funksion të një administrimi sa më të mirë të shoqërisë dhe kryerjes së objektit të veprimtarisë së saj, pranon të gjitha detyrimet e lindura në emër dhe për llogari të saj kundrejt Tirana Bank sha dhe une noteri e vertetoj nenshkrimin e ortakut. Ky akt u realizua ne 4 kopje me fuqi te njeje ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "ANAMARK" SHPK
Z. KLODIAN ALLAJBEU
L52418031N
Kashar, Tiranë

Klodian

Notere
Edlira Malaj (Galanxhi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L52418031N	
2. Data e Regjistrimit	18/12/2015	
3. Emri i Subjektit	ANAMARK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	07/12/2015	
6. Kohëzgjatja	Nga: 07/12/2015 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Ish Ndermarrja e Karburanteve. Km. 1 i Autostrades Tirane - Durres, Zona Kadastrale 2679. Pasuria Nr. 52/7	
8. Kapitali	100,000	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,000	
9. Objekti i aktivitetit	Qiradhenie, tregtim të artikujve ushqimorë etj. Veprimtari të lidhura ose të ngjashme me objektin e shoqërisë.	
10. Administratori/ët	Klodian Allajbeu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/12/2015	Deri: 07/12/2020
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Klodian Allajbeu	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100,000	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,000	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,000	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komentë (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ANAMARK Telefon: 042261901
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 10-05-2019

Armando Mami
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT
 “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K91616015F	
2. Data e Regjistrimit	16/04/2009	
3. Emri i Subjektit	EKMA ALBANIA	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	08/04/2009	
6. Kohëzgjatja	Nga: 08/04/2009 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Ish Ndërmarrja e Karburanteve, Km. 1 i Autostrades Tirane - Durres	
8. Kapitali	100,000	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,000	
9. Objekti i aktivitetit	Shitje, blerje, dhenie/marrje me qira te pronave te paluajtshme, dhenie/marrje ne perdorim si edhe çdo aktivitet tjetër ekonomik te parashikuar nga ligji ne fushen e pronave te paluajtshme. Ndermjetesime ne fushen e pronave te paluajtshme. Aktivitet tregëtar ne fushen e real estate ne pergjithesi. Te realizoje ndertime .Te kryej tregti. Import-eksport te produkteve ushqimore dhe industriale.	
10. Administratori/ët	Klodian Allajbeu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/06/2014	Deri: 06/06/2019
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Haxhi Bardhi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 33,340	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,000	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,340	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)		
12.4 Komete (nëse ka)		
13. Ortakët	ANAMARK	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 33,360	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,000	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,360	
13.6 Komete (nëse ka)		
14. Ortakët	Agromark	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 33,300	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,000	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,300	
14.6 Komete (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: EKMA ALBANIA E-Mail: info@tregushqimor.al Telefon: 2260429	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 10-05-2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

